



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

---

Nr 106 prot.

Tiranë, më 26, 11 2009

**VENDIM Nr. 33, dt. 17.11.2009**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), të VKM Nr. 725, datë 21.05.2008, "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 17.11.2009,

**VENDOSI:**

- I. Bazuar në vëzhgimin intensiv arkeologjik realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Sarandë, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint dhe Instituti i Arkeologjisë, të miratojë projektin e rikonstruksionit të rrugës "Kanali i Çukës - Butrint", paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, me ndryshimet e mëposhtme:
  1. Në Zonën nga KM 0+00 – KM 4+300 Zonën nga KM 4+800 – KM 10+300, është e domosdoshme prezenca e ekspertëve arkeologë gjatë zbatimit të punimeve rrugore.



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

---

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

---

2. Në zonën nga **KM ≈ 4+360** (në kryqëzim të rrugës së Manastirit të Shën Gjergjit) kërkohet kryerja e gërmimeve arkeologjike të shpëtimit përpara kryerjes së punimeve rrugore. Pas kësaj, do të jepet zgjidhja përfundimtare e rakordimeve të këtij kryqëzimi.
3. Në zonën nga **KM ≈ 4+595** (Muri i Demës) do të eliminohet tërësisht zgjerimi në gërmim duke shfrytëzuar gjurmën ekzistuese. Në zonën e intersektimit me Murin e Demës për një hapësirë prej 10 ml, do të lihet krejtësisht e lirë pamja e murit në pjesën e poshtme duke realizuar kalim me gjysëm estakadë. Ndryshimet në këtë zonë shtrihen nga ≈ KM 4+500 – ≈ KM 4+720 me qëllim që të ruhen parametrat e projektit të rrugës.
4. Zona nga **KM ≈ 12+100 – KM 13+440**, për shkak të pontencialit të lartë arkeologjik (ku përfshihen: varreza, kulla e vrojtimit, linja muresh në distanca të ndryshme përgjatë gjatësisë së rrugës ekzistuese) kërkohet rishikim i plotë i projektit duke ndjekur kryesisht gjurmën ekzistuese të rrugës, pa gërmime në krahun e sipërm (majtas), pajisjen me ndriçim rrugor dhe ngushtimin e seksionit tërthor të rrugës. Seksioni tërthor (pjesa kaluese e rrugës) në këtë zonë do të arrijë një gjerësi totale prej 5m plus dy bankinat nga 0,5m dhe një trotuar prej 1,2m në krahun e djathtë, të shoqëruar me parrakë mbrojtës.
5. Sheshet e parkimit të realizohen në **KM 10+300** (para hyrjes në Parkun Kombëtar të Butrintit) dhe në **KM 12+100**, si dhe të jenë të asfaltuara.



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

---

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

---

6. Zona prej KM 13+440 – 13+514, do të rishikohet në një fazë të mëvonshme për shkak të specifikave të rrënojave arkeologjike që gjenden në këtë zonë, përfshirë edhe parkingun ekzistues. Momentalisht kjo zonë nuk do t'i nënshtrohet punimeve ndërtuese.
- II. Punimet për këtë segment rrugor, edhe në zonat ku nuk është vërejtur potencial arkeologjik, do të mbikqyren nga ekspertë arkeologë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Sarandë dhe Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Butrint.
- III. Një kopje me konkluzionet e arritura për ndryshimet në projektin e rikonstruksionit të rrugës “Kanali i Çukës - Butrint”, t'i përcillet përfaqësuesve të UNESCO-s.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

FERDINAND XHAFERRI



SEKRETARI I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al